BASHKIA BERAT
Nr. 1548/2 Prot.
Datë 14.08 2014

# BASHKIA BERAT

## *KONTRATE PER MBIKQYRJEN E PUNIMEVE TE NDERTIMIT NE OBJEKTIN*

***Mbikqyrja e punimeve per "Rikonstruksion I Shetitores Osumi Berat"***

-2014

"VLADI-INVEST"

24

**_KONTRATE PER MBIKQYRJEN E PUNIMEVE TE NDERTIMIT NEOBJEKTIN:_**

***Mbikqyrja e punimeve per "Rikonstruksion I Shetitores Osumi Berat"***

Lidhur sot ne date 14 /07 /2014 prane Bashkise Berat, midis paleve te meposhteme:

**Autoriteti Kontraktor**, Bashkia Berat, perfaqesuar nga Kryetari i Autoritetit Kontraktor z.Fadil NASUFI.

**Mbikqyresi i Punimeve**: JV,"Vler-Invest & Infratech" shpk , me numer licence MK 1554/6 perfaqesuar nga Drejtues Ligjor Bashkim SALI.

**Objekti i Kontrates**: Marrja persiper e mbikqyrjes se punimeve nga JV "Vler-Invest & Infratech" shpk , me numer liçence MK. 1554/6 kontrolli e mbarevajtja e te gjithe procesit te zbatimit te punimeve, ne perputhje me projektin, kushtet teknike te projektimit, te zbatimit si dhe destinacionin e objektit, duke patur parasysh dhe anen ekonomike te tij,ne objektin:

***"Mbikqyrja e punimeve per "Rikonstruksion I Shetitores Osumi Berat"***

**Afati i kontrates**. Kontrata do te realizohet brenda 90 (nentedhjete ) diteve, nga dita e lidhjes se kontrates

**Gjuha e kontrates**. Gjuha ne te cilen perpilohet kontrata eshte gjuha shqipe.

***I.Detyrat dhe pergjegjesite e mbikqyresit te punimeve***.

Mbikqyresi i punimeve mban dhe pergjigjet per : 1.-Zbatimin Projektit te firmosur nga projektuesi. Leja e zhvillimit miratuar nga Kryetari i Bashkise me kondicionet perkatese.

2.Dokumentacionin topogafik dhe gjeologo-inxhinjerik te punimeve te maskuara.

3.Dokumentacionin perkates per te gjitha ndryshimet e mundshme qe mund te jene bere ne projekt gjate ndertimit te objektit,

4.Plan -organizimin e punimeve.

Mbikqyresi i punimeve eshte i detyruar te kontrolloje periodikisht dhe ne fazat me kryesore, librin e kantierit dhe eshte pergjegjes per saktesimin e vertetesise se dokumentave qe pasqyrohen ne te.

Mbikqyresi i punimeve duhet te verifikoje:

1.Dokumentacionin perkates te licencave.

2.Verifikimin e sheshit te ndertimit, nese eshte i lire dhe i gatshem per te filluar punimet.

Vlera e kontrates eshte ***350 400(treqinde e pesedhjetemije e katerqinde) leke me tvsh.***

3.Njohjen me hollesi te kontrates se sipermarrjes dhe te gjitha akteve administrative qe lidhen me te si dhe njohjen e ndryshimeve te mundshme te kontrates.

4.Vendosjen e tabeles se identifikimit me keto te dhena:

- Emertimi i objektit
- Data e marrjes se lejes se zhvillimit
- Investitori
- Projektuesi
- Sipermarresi dhe drejtuesi teknik
- Mbikqyresi
- Afati i ndertimit
- Siperfaqa e ndertimit
- Intensiteti sizmik i sheshit te ndertimit.

Mbikqyresi i punimeve harton dokumentacionin e meposhtem:

1.Aktin e dorezimit te sheshit te ndertimit, shoqerise sipermarrese.

2.Aktin e dorezimit nga sipermarresi te dokumentacionit teknik dhe administrative si licenca, autorizime e leje te marra nga sipermarresi.

3.Shkresen me ane te se ciles njofton Bashkine per fillimin e punimeve.

***I. Te drejtat e mbikqyresit te punimeve.***

1.Jep instruksione dhe urdhera me shkrim,sipermarresit ne zbatim te akteve ligjore e nenligjore.

2.Propozon largimin nga puna te nje ose te disa personave nga personeli i sipermarresit.

3.Materialet ne veper perdoren vetem me miratimin e mbikqyresit te punimeve.

4.Ka te drejte te kerkoje kryerjen e provave te materialeve te vendosura ne objekt.

5.Kur mendon se ka defekte ne zbatimin e punimeve kerkon verifikimin perkates.

6.Kontrollon zbatimin e grafikut dhe i raporton cdo muaj investitorit per realizimin e tij.

***II.Te drejtat e Autoritetit Kontraktor.***

1.Kerkon largimin dhe zevendesimin e mbikqyresit, kur vertetohen mangesi serioze si me poshte:

a.Mangesi ne plotesimin e detyrave.

b.Nderprerjen e paarsyeshme te punimeve dhe zgjatje e theksuar e tyre.

c.Mangesi kontrolli ne kosto e kontabilitet.

Nje kopje te dokumentacionit, e miratuar nga mbikqyresi i punimeve i dergohet kolaudatorit te objektit.

Mbikqyresi mer pjese ne kolaudimin e vepres, i pergjigjet kolaudatorit me dokumentacionin e nevojshem dhe firmos proces verbalin e kolaudimit. Kontrollon dhe miraton situacionet e paraqitura nga sipermarresi dhe i dergon ne drejtorine e finances per pagim.

Mbikqyesi kontrollon dhe autorizon perdorimin e fondit rezerve dhe i raporton periodikisht investitorit per gjendjen e tij.

Kur verehen shkelje te renda te dispozitave ligjore, investitori ka te drejte te urdheroj mbikqyresin e punimeve per nderprejen e punes.

Per shkeljet e dispozitave ligjore vendosen sanksione ne baze te neneve 15, 16 te kreut te III te ligjit nr. 8402 date 10.09.1998 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit"ndryshuar me ligjin nr 9794 date 23.07.2007"Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit"

Kjo kontrate u perpilua duke u bazuar ne legjislacionin perkates, ne Udhezimin nr. 3 date 15.02.2001 "Per mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndertimit",Vvkm nr 444 date 05.09.1994 "Per tarifat e studimit e projektimit,drejtimit dhe kolaudimit te veprave te ndertimit" ,me ndryshimet perkatese si dhe ne legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Kjo kontrate hartohet ne 6(gjashte) kopje: nje mbikqyresi i punimeve, nje sipermarresi, kater kopje Autoriteti Kontraktor me cilesine e Investitorit.

| | |
|---|---|
| **MBIKQYRESI I PUNIMEVE** | **AUTORITETIT KONTRAKTOR** |
| **"VLER –INVEST&INFRATECH"sh.p.k** | **BASHKIA BERAT** |
| **Drejtues Ligjor** | **TITULLARI** |
| **Bashkim SALI** | **Fadil NASUFI** |

REPUBLIKA E SHQIPERISE BASHKIA BERAT